

REZOLUTE
Nr.3, datë 6.8.1998

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, duke ndjekur me shqetësim të veçantë dinamikën e zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë dhe situatën e atjeshme gjithnjë e më të rënduar, konstaton se:

- tashmë lufta ka përfshirë gjithë Kosovën;
- Milosheviçi po përdor forcat ushtarake dhe civilët serbë kundër popullsisë civile shqiptare duke e kthyer konfliktin në Kosovë në një luftë të mirëfilltë etnike, gjë që mbart rrjedhimet më të rënda për stabilitetin në rajon;
- Milosheviçi po përpaket të realizojë jo vetëm ndryshimin e raporteve etnike, por edhe shtypjen e cdo kërkesë për urinë dhe të drejtat njerëzore të shqiptarëve të Kosovës;
- Milosheviçi, në zbatim të strategjise së tij të përbindshme, po djeg e shkatërron krahina të tera, me shperngulje të qindra mijë banorëve dhe masakrimin e familjeve të tëra;
- provokacionet serbe në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, me dhjetë shtetas të vrarë dhe me goditje të ndërtesave, po marrin zhvillimin e një agresioni të hapur;
- operacionet ushtarake serbe në Kosovë e rreth saj po vënë nën kërcënim serioz paqen në Ballkan e më gjerë.

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë:

- vlerëson iniciativat e komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen e shpejtë dhe afatgjatë të problemit të Kosovës dhe në këtë kuadër shpreson se Presidenti Clinton do të marrë edhe një herë në shqyrtim paralajmërimin e Tij fisnik se nuk do të lejojë që Kosova të kthehet në një Bosnjë të dytë;
- përshëndet letrën e 20 qershorit 1998 të një grupi të madh kongresmenesh amerikanë drejtuar Presidentit Clinton, në të cilën ndër të tjera kërkohet t'i bëhet paralajmërim Milosheviçit që të ndal menjëherë të gjithë sulmet, përndryshe të përballët me ndërhyrjen e shpejtë të NATO-s; në këtë letër afirmohet gjithashtu e vërteta e qartë se është i njëjti Milosheviç krimeve në Bosnjë që po vepron edhe në Kosovë;
- vëren edhe një herë se kërkesa e komunitetit ndërkombëtar për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Kosovë është keqpërdorur nga Milosheviçi për të vazhduar operacionet shfarosëse, ai vazhdon ta sfidojë këtë komunitet;
- i bën thirrje OKB-së, Këshillit të Sigurimit, OSBE-së, KE-së, BE-së, NATO-s dhe BEP-it me kërkesë për ndërhyrje ushtarake të menjëhershme të NATO-s në Kosovë, si e vetmja rrugë për të ndaluar luftën dhe për të nisur negociatat për një zgjidhje paqësore;
- u ben thirrje Kongresit dhe Senatit të SI-IBA-së dhe gjithë parlamentëve të vendeve anëtare të Këshillit të Europës, që të ndikojnë në qeveritë përkatëse për një veprim të menjëhershëm në lidhje me Kosovën. Është deklaruar që Perëndimi nuk do të lejojë përsëritjen e Bosnjës në Kosovë; tre vjet pas Srebrenicës, në Kosovë po ndodhin të njëjtat masakra, që përkohësisht mbahen të mbuluara, por që bota do t'i njohë; nëse nuk veprohet sot, nesër do të jete vonë, jo vetëm për shqiptarët, por për të gjithë Ballkanin dhe më gjerë;
- shpreh bindjen se në interes të çështjes së madhe të përbashkët, të gjithë faktorët shqiptarë që veprojnë në Kosovë, si faktorët politike e shoqërore, ashtu edhe forcat e UCK-se, e cila po mbron me vetmohim popullin e vet, do të arrijnë shumë shpejt që të realizojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e nevojshëm të domosdoshëm të mendimit dhe të veprimit, në të gjithë spektrin e vet, përfshirë edhe komunikimin me faktorin ndërkombëtar, nëpërmjet një strukture gjithëpërfaqësuese të shqiptarëve të Kosovës; kjo do të ndihmonte përmbushjen e misionit historik kombëtar, për ta çuar Kosovën në arritjen e vetëvendosjes politike;
- u bën thirrje edhe njëherë gjithë forcave politike në Shqipëri që të formulojnë dhe realizojnë një qëndrim të përbashkët për një mbështetje sa më të fuqishme për Kosovën, e cila po qëndron me heroizëm përballë makinës ushtarake serbe;
- rithekson nevojën e një impenjimi maksimal nga ana e Qeverisë Shqiptare për realizimin e të gjitha masave të domosdoshme për sigurimin e mbrojtjes së vendit, për trajtimin e refugjatëve të ardhur nga Kosova dhe për vazhdimin intensiv të gjithë veprimtarisë përkatëse diplomatike të vendit tonë;
- ngarkon komisionet përkatëse të ndjekin me vëmendje zhvillimet e situatës në Kosovë, në lidhje me këto zhvillime, Kryesia e Kuvendit Popullor të thërrasë një tjetër sesion plenar në çdo

moment që ta konsiderojë të domosdoshëm.

Kjo rezolutë t'u dërgohet gjithë strukturave ndërkombëtare të përmendura në të.